



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



02/ Nr. 7626
Data: 12.09.2022

PROCESVERBAL I DËGJIMIT BUXHETOR NË FSHATIN SEÇISHTË

Procesverbali nga Dëgjimi i gjashtë Buxhetor në lidhje me Draft Buxhetin e Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2023 dhe parashikimi për vitet 2024-2025, të mbajtur me datën **24.08.2022**, duke filluar nga ora **18:00** në Sh.F.M.U. "Ilaz Thaçi" (paralele) në fshatin Seçishtë, me gjithsej 21 pjesëmarrës, prej tyre 15 burra dhe 6 gra. Nga ekzekutivi, të pranishëm ishin Nënkryetari i Komunës **z. Sevdi Dernjani**, Kryesuesi i Kuvendit **z. Florim Shkreta**, Drejtoresha për Buxhet dhe Financa **znj. Lindita Ballazhi**, si dhe drejtorët e drejtorive.

Takimin e kryesoi Nënkryetari i Komunës **z. Sevdi Dernjani**, i cili iu uroi mirëseardhje të pranishmëve që kishin gjetur kohë për të ardhur në dëgjimin buxhetor për prezentimin e draft buxhetit të Komunës Hanit të Elezit për vitin 2023, si dhe parashikimi për vitet 2024-2025, ku për rend të punës, ishte:

1. **Prezentimi i draft buxhetit të Komunës Hani i Elezit për vitin 2023 dhe parashikimi për vitet 2024-2025**
2. **Diskutimi**

Sevdi Dernjani: Prezentimin e draft buxhetit do ta bëjë Drejtoresha për Buxhet dhe Financa.

1. **Prezentimi i draft buxhetit të Komunës Hani i Elezit për vitin 2023 dhe parashikimi për vitet 2024-2025**

(Drejtoresha **Lindita Ballazhi** përshëndeti dhe falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në dëgjimin buxhetor)

Lindita Ballazhi thekson: Buxheti komunal paraqet një instrument mjaft të rëndësishëm financiar në të cilin specifikohen të hyrat dhe shpenzimet për një periudhë të caktuar kohore një vjeçare, duke filluar nga 1 janar deri në 31 dhjetor. Planifikimi i Buxhetit Komunal kalon nëpër disa faza, bazuar në Ligjin Nr.03/L-48 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Planifikimi buxhetor fillon me lëshimin e Qarkores së parë Buxhetore nga Ministria e Financave që bëhet së fundi deri me 15 maj. Faza e dytë është hartimi i KAB-it në bazë të Qarkores Buxhetore ku kemi kufijtë fillestarë buxhetor. Për hartimin e KAB-it ne kemi mbajtur konsulta me asamblesë komunale, dëgjime buxhetore me qytetarët, si dhe është bërë miratimi i KAB-it në Kuvend Komunal më 30 qershor. Faza vijuese është pranimi i Qarkores së dytë Buxhetore nga ana e Ministrisë së Financave, e cila lëshohet më 15 gusht dhe më pas kemi bërë përgatitjen e

draft buxhetit, si dhe vijon mbajtja e dëgjimeve publike. Faza përfundimtare e planifikimit buxhetor është miratimi i draft buxhetit në Kuvend Komunal, dhe veprimi i fundit është dorëzimi i draft buxhetit në Ministri të Financave deri më së voni 30 shtator. Buxheti i komunës përfshin këto struktura të financimit, ku për vitin 2023 do të jenë: granti i përgjithshëm (1,431,545€), granti specifik për arsim (993,487€), granti specifik për shëndetësi (364,561€) dhe të hyrat vetanake komunale (560,121€). Pra, buxheti total për vitin 2023 do të jetë 3,349,714€. Në vazhdim, kemi bërë planin e ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale për vitin 2023, siç e shihni në projektor, këtu kemi të përfshime drejtoritë komunale, shëndetësinë dhe mirëqenien sociale, si dhe arsim dhe shkencë. Ndarja e buxhetit është bërë në bazë të kufijve buxhetor, për çdo kategori buxhetore: paga dhe shtesa, mallra dhe shërbime, shpenzime komunale, subvencione dhe transfere, si dhe shpenzime kapitale. Nëse e krahasojmë me vitin e kaluar, kemi një rritje të dukshme në të gjitha kategoritë buxhetore. Mandej vijnë të gjitha projektet kapitale të cilat i keni para vetes tuaj në letër, të cilat janë planifikuar nga drejtoritë dhe ekzekutivi, si dhe disa janë marrë edhe nga dëgjimet paraprake që kemi pasur në qershor dhe nuk po ju detajeve. Nëse keni ju ndonjë projekt propozim apo kërkesë, mundeni ta parashtroni.

2. Diskutimi

Sevdi Dernjani: Pas prezentimit nga Drejtoresha, e shpall të hapur diskutimin.

Mevlduin Kuka: Si administrator i fshatit Seçishtë, nga biseda me bashkëvendasit, disa nga prioritetet që mendoj se janë më të nevojshme për fshatin Seçishtë. janë këto si më poshtë:

- 1) Kanali i ujitjes në Lloka që kushton diku 14 mijë €;
- 2) Pyllëzimi i Shullanit, ku kemi 4 vite që e kërkojmë, jemi tu dasht me prek me dorë këtë projekt, s'paku 100-200 fidane për me pa se qysh po shkon, madje ne kemi mendu edhe në mënyrë vullnetare me u angazu vet banorët për 5 hektarë të kësaj pjese, nëse s'na bëhet zgjidhje nga ju;
- 3) Rregullimi i rrugës nërbregut, që është rruga që shkon rreth Lepencit, prej te kroi këtu deri te Kalist atje poshtë, ku s'paku me e shtru me zhavor ;
- 4) Rruga e burimit të lumit Lepenc;
- 5) Penda në Sarasellë

Sevdi Dernjani: Pendën në Sarasellë, ne e kemi paraparë në vlerë prej 5 mijë €, rregullimin e kanalit të ujitjes në vendin e quajtur Lloka gjithashtu është e paraparë në listën e projekteve, poashtu përmende edhe ndërtimin apo rregullimin e një rruge rreth Lepencit, ne këtë projekt e kemi të paraparë për të gjitha fshatrat e komunës, ku janë ndarë 60 mijë €. Kurse për pyllëzimin, le të flet Drejtori i Bujqësisë dhe Pylltarisë, meqë e kemi këtu.

Abdurahman Bushi: Para 3 javëve kam bo kërkesë në Agjencinë e Pyjeve për çshtjen e pyllëzimit të Shullanit, por nuk kam marr përgjigje deri sot, megjithëse ka premtime që mund të realizohet. Nëse nuk realizohet nga Agjencia dhe ju doni me bo punë vullnetare, unë jam krah juve. Pyllëzimi i një hektarë kushton 1500-1600€, dhe pjesa e Shullanit i ka 13 hektarë e pak metra. Me e pyllëzu, afërsisht bën 20 mijë €. E nëse vjen puna që refuzohet nga Agjencioni, atëherë nëse i mbledhni ju 20 mijë €, unë personalisht do të merrem me e lëshu lejen për pyllëzim, meqë nuk i kemi 20 mijë € në buxhetin e drejtorisë për pyllëzim.

Akif Shkreta: Fillimisht mendoj se ne si banorë të fshatit Seçishtë, duhemi të listojmë projektet më me prioritet, sepse ka shumë porjekte kapitale, por që komuna ka buxhet të vogël dhe s'munden me u përfshi krejt projektet e fshatit Seçishtë. Për mu perosnalisht, më me prioritet është hapja e rrugës për në vorba, sepse aty kanë fillu të ndërrojnë kamp-shtëpiza, e me hapjen e rrugës ishin shtu vizitorët dhe ishte zhvillu më shumë ajo pjesë. Gjithashtu, si drejtor i shkollës, nuk mund të koncentrohem edhe te fusha e arsimit, nuk besoj se shuma e mjeteve mundet me qenë e madhe, më saktësisht shkollës i nevojitet një wc në pjesën e aneksit, poashtu duhet me u vendos një mur mbrojtës përreth, sepse ka shëmbje të dheut, si dhe një gjenerator.

Sevdi Dernjani: Njëjtë si te fshati Gorancë, është një problem te kjo rruga për te vorba, sepse ka prona private dhe duhen me u marr pëlqimet e pronarëve, ne mundemi me e marr një gjeodet dhe me i caktu zonat kadastrale. Kurse te propozimi për rregullimin e infrastrukturës shkollore në Seçishtë, ky projekt është i paraparë në listën e projekteve, ku janë ndarë 60 mijë € për rregullimin e infrastrukturës në të gjitha shkollat e Hanit të Elezit.

Mervet Kalisi: Unë mendoj se prioritetet kryesore për komunitetin janë uji i pijes, kanalizimet, rruga e vorbës me u shtru me zhavor, rruga në Lozhë.

Sevdi Dernjani: Për të gjitha këto, me buxhet komunal nuk mundemi me i realizu, por e rëndësishme është që me propozimet e juaja këto futen në listën e projekteve dhe votohen në Kuvend, e nëse kalojnë në Kuvend e edhe në nivel qendror, atëherë ne mundemi me apliku nëpër organizata të ndryshme, ose edhe ju si banor, dhe veç fakti që është në listë të projekteve, ne si komunë automatikisht e japim lejen për çdo projekt që mundet me u ofru ndonjë donator me e realizu.

Ibadete Kalisi: Një nga problemet që përballemi është rryma elektrike. Dhe mendoj se me fillimin e shkollës, do të paraqes problem rryma për mbajtjen në rregull të procesit mësimor dhe do të ishte mirë që shkolla me u pajis me një gjenerator.

Sevdi Dernjani: Kët' po e marrim si kërkesë dhe nëse mundemi me e realizu në kuadër të projektit për rregullimin e infrastrukturës.

Hisni Luri: Ne i kemi rrit mjetet në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, dhe në kuadër të kësaj ne mundemi me i realizu këto kërkesa që nuk përfshihen në projekte kapitale. Te shkollat diçka më urgjente sa i përket projekteve kapitale janë shkallët emergjente nëpër shkolla.

Sevdi Dernjani: A ka edhe dikush diçka me shtu apo me plotësu? Nëse nuk ka, e shpall të mbyllur dëgjimin buxhetor në fshatin Seçishtë.

Mbledhja përfundoi në ora 18:37.

Procesmbajtësja
Liridona Ballazhi

